

05

BULETINI I RIMËKËMBJES

mars 2021



Kah shkuan paratë e TRUST-it?

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) në botimin e tij periodik të Buletineve të Rimëkëmbjes, shpalosë më të rehat rreth Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Këto Buletine kanë për qëllim që përmes informacioneve, me një gjuhë dhe terma sa më të thjeshtë të i shpalosë para publikut të gjerë elementet kryesore të Ligjit të Rimëkëmbjes dhe Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike për pandeminë COVID-19. Kjo në mënyrë që çdoherë e më shumë të rritet transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve të Kosovës nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky edicion i Buletineve shpalosë temën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, mundësinë e tërheqjes së 10 përqindëshit të kursimeve nga kontributdhënësit dhe impaktin që e ka kjo masë në rimëkëmbjen ekonomike.



Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur dhe jo-për-profit, i cili është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. FKPK është krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, që nënkupton se secili kontribues kursen për pension në një llogari personale. Aktiviteti i përgjithshëm i FKPK-së rregullohet nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa mbikqyret nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

Punëdhënësit kanë për obligim që të deklarojnë obligimin për pagesë të kontributeve pensionale ndaj të punësuarve të tyre përmes sistemit online të deklarimit në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Deklarimi bëhet përmes ngarkimit të listës së të punësuarve në sistemin e deklarimit online, EDI, në ATK. Pas deklarimit, sistemi online prodhon fletëpagesat përkatëse përmes të cilave bëhet pagesa në cilëndo prej bankave komerciale ose institucioneve të licencuara për pagesa të këtilla.

Kontributet e mbledhura investohen në tregjet globale financiare që pritet të rriten në vlerë, ndërkaq kthimi nga investimet shpërndahet proporcionalisht nëpër llogaritë individuale. FKPK-ja ngarkon taksë mbi mjetet pensionale për t'i ushtruar funksinet dhe përgjegjësitë e saj (taksën investive prej 0.330% në vit dhe taksën operacionale prej 0.065% në vit, norma këto të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës dhe në fuqi prej 5 qershorit 2020).

Fondi përbëhet nga vetëm një portofolio për të gjithë pjesëmarrësit. Në këtë mënyrë, balancohen interesat e personave që do të pensionohen në të ardhmen e afërt me interesat e atyre që kanë kohë më të gjatë para pensionimit. Politika investuese synon t'i zbusë efektet negative të tregjeve në rënie e duke marrë pjesë në fitime kur tregjet ngriten. Kjo qasje e qëndrueshme synon të akumulojë kthime të balancuara për të gjitha grupmoshat.

Tërheqja e 10 përqindëshit të Trustit

Qeveria e Kosovës si përgjigje ndaj situatës pandemike gjatë muajit dhjetor 2020 miratoi Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Përmes këtij Ligji si masë për rimëkëmbje ekonomike, Qeveria e Kosovës ka përfshirë edhe tërheqjen e 10 përqindëshit të kontributeve personale në mënyrë që të kjo masë të ndihmojë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit së bashku edhe me masat e tjera që përfshinë ky ligj.

Në bazë të këtij Ligji, “pjesëmarrësit në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës mund të tërheqin 10% të kursimeve të tyre pensionale si shkak i krizës që është shkaktuar nga pandemia”. Aplikimi për tërheqjen e 10% të trustit ka filluar me datën 11 dhjetor 2020 dhe do vazhdojë deri më 6 prill 2021. Pas asaj date nuk do të mund të aplikohet për këtë tërheqje, andaj kërkohet nga të gjithë kontribuesit që nëse duan ta aplikojnë për tërheqje këtë ta bëjnë deri në atë datë.



Ndikimi i 10 përqindëshit të Trustit në Rimëkëmbjen Ekonomike

Mundësia që i është dhënë kontributdhënësve për tërheqjen e 10 përqindisht të kursimeve nga Trusti pritet që do të ndihmojë në rritjen e kërkesës agregate duke rritur konsumin, sektorin e shërbimeve, dhe në disa raste edhe ndërtimtarinë. Kjo pasiqë duke rritur kërkesën agregate shteti do të përfitojë nga Tatimi në Vlerën e shtuar si përfitim direkt. Kurse, sa i përket përfitimit indirekt, vlera e tij padyshim se do të jetë shumë më e madhe pasi që do të ndikojë në ruajtjen e vendeve të punës, sektor ky i cili rrezikohet të çëmtohet shumë nëse pandemia do të vazhdojë me të njëjtin trend edhe për një kohë të pacaktuar.

Se ka filluar të ndikojë në Rimëkëmbje Ekonomike kjo masë dhe masat e tjera të cilat u aprovuan me miratimin e Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike mund ta ilustrojmë edhe përmes të dhënave që i gjejmë tek Agjencia Statistike e Kosovës (ASK). Sipas ASK, eksporti i mallrave në muajin janar 2021 kishte vlerën 42,5 milion euro, ndërsa importi 235,8 milion euro, është një rritje prej (47.1%) për eksport si dhe (6.6%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Këto vlera më së miri dëshmojnë se menëherë pas mundësimit të tërheqjes së 10 përqindëshit nga Trusti, ku vetëm deri më datë 31 dhjetor 2020, u janë shpague qytetareve të Kosovë rreth 184 milion euro.



Të dhënat e deritanishme nga tërheqja e 10 përqindëshit të Trustit


Nga të dhënat e marrura nga publikimet e faqes së Trustit mund të theksojmë se janë gjithsej 644,582 aplikues potencial të cilët kanë të drejtë të i tërheqin 10 përqind nga kursimet e tyre pensionale. Prej tyre, të gjithë kontributdhënësit të cilët shprehin vullnetin që të i tërheqin këto shuma, do të përjashtohen nga tatimi në të ardhura personale.

Se interesimi për tërheqjen e 10 përqindëshit të Trustit është shumë i madh, dallohet edhe nga numri i aplikuesve në njëzet ditëshin e parë. Vetëm deri më 31 dhjetor 2020, kanë aplikuar më shumë se gjysma, përkatësisht 397,573 aplikues prej numrit total të aplikuesve potencial. Kjo e shpjegon faktin se në rrjedhën e ekonomisë së vendit kanë hyrë rreth 185,356,099 euro të cilat kanë ndikuar edhe në ngritjen prej rreth 6% të importit në vend.

Aplikimet për tërheqjen e 10% (11 dhjetor-31 dhjetor 2020)

Shuma e 10% për tërheqje	Kanë aplikuar	Aplikues të mundshëm	Përqindja që kanë aplikuar	Përqindja e mundshme	Vlera e tërhequr
Deri €10	10,198	99,800	8.2%	10.20%	€ 57,565
€11 deri €50	55,876	135,211	33.8%	41.30%	€ 1,621,166
€51 deri €100	50,884	80,547	52.8%	63.20%	€ 3,746,351
€101 deri €200	66,899	88,495	64.3%	75.60%	€ 9,745,385
€201 deri €500	94,265	109,791	74.9%	85.90%	€ 30,394,358
€501 deri €1000	68,459	73,026	86.3%	93.70%	€ 50,825,689
€1001 deri €2000	39,277	43,851	80.9%	89.60%	€ 51,966,941
€2001 deri €4000	9,790	11,568	74.2%	84.60%	€ 26,361,467
Mbi €4000	1,925	2,293	72.6%	84.00%	€ 10,637,177
Gjithsej	397,573	644,582	53.4%	61.70%	€ 185,356,099

Aplikimet për tërheqjen e 10% (11 dhjetor-31 dhjetor 2020)



Të dhënat e deritanishme nga tërheqja e 10 përqindëshit të Trustit

Llogaritë e hapura prej themelimit

712,915

Llogaritë aktive për vitin aktual

279,794

Mjetet neto nën menaxhim

€2,025,206,276

Si aplikohet për 10 përqindëshin e Trustit?

Duke parë se jemi duke u afruar rreth përfundimit të afatit për aplikimin e tërheqjes së 10 përqindëshit të mjeteve nga kursimet e kontributdhënësve në Trust, ne do ju njoftojmë edhe njëherë rreth formës së aplikimit. Ju duhet që të aplikoni në faqen zyrtare të Trustit:

www.trusti10.org

Për të aplikuar ju duhet të keni gati:

1. Numrin tuaj personal
2. Numrin e llogarisë tuaj bankare, në të cilën dëshironi ta pranoni 10%-shin.

Keni kujdes!

Llogaria bankare të cilën duhet ta vendosni duhet pajtë të jetë vetëm llogari e juaja personale, dhe JO llogari biznesi apo e ndonjë personi tjetër. Po ashtu, llogaria duhet të jetë në një bankë të Kosovës.

Kanë mbetur edhe shumë pak ditë deri në përfundimin e afatit për aplikimin për tërheqjen e parakohshme të 10 përqind të Trustit, prandaj nëse dëshironi të i tërheqni, mos e kaloni afatin kohor!

Aplikimi përfundon më: 06 prill 2021.

05

BULETINI I RIMËKËMBJES

mars 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).